



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr.Reshit Çollaku. Tel: 0800 9999. Fax: 042 228-516. Website: eee.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKP

08418
2013

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklaram të interesave private të tij, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ", me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr.9367, dt.7.4.2005, ligjin nr.9475, dt.9.2.2006, ligjin nr.9529, dt.11.5.2006 dhe me Ligjin Nr. 85/2012 datë 18.09.2012.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Emri	Atësia	Mbiemri
Hantin	Jean	Bonati
Funksioni		
Drejtor i Përgjithshëm		
Institucioni dhe adresa		
Ministria e Punëve të Brendshme, Adresa: Sheshi "Skënderbej", nr.3		
Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës	
18.11.2013	17.12.2013	

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë " i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi

Hantin Bonati

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklaramit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të zotëruara nga zyrtari, ose në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr. Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit Vlera me shifra dhe me fjalë në %

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)
1	Apartament banimi, sip 140 m ² , rruga [redacted] [redacted] Tiranë, blerë më datë 20.3.2007 (shiteshi nëna që e ka përfituar si ish pronare truall) Burimi i krijimit: Paga e përfituar dhe kursimet e viteve	1.200.000 lekë (një milion e dyqind mijë)	100%	Kopje e kontratës së shitblerjes (nr. Fletesh 1)
2	Apartament banimi, sip 70 m ² , rruga [redacted] [redacted] Pogradec, blerë më datë 3.5.2012 (bashkëpronësi me bashkëshortin - likuiduar me kështu) Burimi i krijimit: Paga ime, bashkëshortes dhe qeraja e përfituar gjatë viteve	4.600.000 lekë (katër milion e gjashtëqind mijë)	100% bashkëpronësi me bashkëshortin	Kopje e kontratës së shitblerjes (nr. Fletesh 1)
3	Autoveturë tip Volkswagen, viti i prodhimit 2005, me targë [redacted] blerë më datë 10.08.2012. Burimi i krijimit: Paga ime, bashkëshortes dhe qeraja e përfituar gjatë viteve	7800 euro (Shtatë mijë e tetëqind)	100%	Kopje e kontratës së shitblerjes (nr. Fletesh 1)
4	Autoveturë tip Peugeot, viti i prodhimit 2003, me targë [redacted] blerë më datë 02.07.2013. Burimi i krijimit: Paga ime, bashkëshortes dhe qeraja e përfituar gjatë viteve	1400 euro (Një mijë e katërqind)	100%	Certifikata e pronësisë së mjetit (nr. Fletesh 1)
5	Llogari rrjedhëse pranë [redacted] Burimi i krijimit: Kursime nga paga ime, bashkëshortes dhe qeraja e përfituar gjatë viteve	7888 euro (Shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë)	100%	
6	Likuiditete (banka [redacted], pranë shërbës) Burimi i krijimit: Kursime nga paga ime, bashkëshortes dhe qeraja e përfituar gjatë viteve	140.000 lekë (Njëqind e dyzet mijë)	100%	

* Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003,

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 500 000 leke;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

“Para Fillimit të Detyrës”

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Hantin Bonati

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklarimit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të zyrtarit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 janar, deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit;

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit në detyrë.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)
Të ardhura nga paga për periudhën: 1 janar 2013 – 18 nëntor 2013 të përfituara si manaxher pranë kompanisë “Magnum Opus Group” sh.p.k	1.200.000 lekë (një milion e dyqind mijë)	Vërtetim page (nr.fletëve 1)
Të ardhura nga paga e bashkëshortes për periudhën: 1 janar 2013 – 18 nëntor 2013 të përfituara si drejtor pranë kompanisë “Albtelekom” sh.a.	3.350.362 lekë (tre milion e treqind e pesëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy)	Vërtetim page (nr.fletëve 1)
Të ardhura nga qeraja e apartamentit në pronësi në rrugën [redacted] të Tiranë, për periudhën: 1 janar 2013 – 18 nëntor 2013	8.800 dollar amerikan (tetë mijë e tetëqind)	

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Hantin Bonati

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të punës prej zyrtarit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr.7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe koston mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të punës. (me shifra dhe me fjalë)	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Hantin Bonati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr. Reshit Çollaku, Të: 0800 9999, Fax: 042 228-516, Website: eec.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi
në ILDKP

Plotësohet nga pjesetaret e familjes (bashkëshorti/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/sja **IRIDA LUAN BONATI**
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshort/e ☒
fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐

e Subjektit **HANTIN JEAN BONATI**
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐
Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☒

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Irida Bonati

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.


Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)
1	Apartament banimi, sip 70 m², rruga [redacted] [redacted] Pogradec, blerë më datë 3.5.2012 (bashkëpronësi me bashkëshortin / likuiduar me kështu) Burimi i krijimit: Paga ime, bashkëshortit dhe qeraja e përfituar gjatë viteve <u>(Sikurse deklaruar dhe tek deklarata e bashkëshortit)</u>	4.600.000 lekë (katër milion e gjatëqind mijë)	100% bashkëpronësi me bashkëshortin	Kopje e kontratës së shitblerjes

*Objekti i deklarimit (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 500 000 leke;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Irda Bonati



**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

- Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data 1 janar, deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit të zyrtarit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit në detyrë.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)
Të ardhura nga paga për periudhën: 1 janar 2013 – 18 nëntor 2013 të përfituara si drejtor pranë kompanisë “Albtelekom” sh.a. <u>(Sikundër deklaruar dhe tek deklarata e bashkëshortit)</u>	3.350.362 lekë <i>(tre milion e treqind e pesëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy)</i>	Vërtetim page <i>(nr. fletëve 1)</i>

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**


- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të punës të zyrtarit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr.11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, si dhe dokumentat shoqërues që disponohen.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të punës. (me shifra dhe me fjalë)	Dokumenta justifikues (Nr. Fletëve)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Irida Bonati



Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në dy ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesa

- Ligj nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar

Deklarimi i interesave private nga zyrtari

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës” duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit nga funksioni i mëparshëm.
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Bashkëlidhur me deklaratën subjekti duhet të sjellë edhe dokumente justifikuese. Në çdo rast duhet që të dhënat që përmbajnë këto dokumenta të jenë pasqyruar edhe në faqet përkatëse të deklaratës.
- Formulari i deklarimit plotësohet me shkrim dore ose në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
- Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, jo më vonë se 30 ditë, nga data e fillimit të detyrës.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga pjesëtarë të familjes (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 7-11.
- Në çdo rast, subjekti është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 19 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar
- Për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi dënohet me gjobë nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen nga deklaruesi dhe të bashkëlidhen dokumentat justifikues për çdo pasuri, të ardhur të përfutur dhe detyrime, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e pa dorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme apo asistencë në plotësimin e deklaratës, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me “Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, Zyrtarët dhe Publikun” në numrat e telefonit 042 231-201, 042 259-472, Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.